

STATUT I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

F.R.CONSTRUZION SHPK

Ne Tirane, sot me date 10 Janar 2023 u mblodh Asamblea e Ortakut te Vetem te Shoqerise me prezencen e Ortakut te Vetem te saj z.Fatos Roumelioti, shtetas shqiptar, i biri i Vladimirit, lindur ne Seman, Fier, me 08 Shkurt 1985, banues Tirane, madhor me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet dokumentit te identifikimit me nr personal I50208020E i cili me cilesine e "ortakut te vetem themelues" redaktoi kete Statut, nepemjet te cilit deklaron se me vullnet te lire te plete e te sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin nr 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar me ligjin nr 129/2014 date 01.10.2014, ne ligjin nr 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", i ndryshuar me ligjin nr 131/2015 date 26.11.2015, ne legjislacionin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar, "**F.R.Construzion shpk.**

KREU I

Neni 1 Krijimi

1.1 Shoqeria *F.R.Construzion shpk*, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2 Personaliteti juridik

2.1 Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligjislacionin Shqiptar ne fuqi.

2.2 Shoqeria, pasi te ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj te tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

2.3 Shoqeria **F.R.Construzion shpk**, eshte nje e tille, kapitali i se cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës se kontributit te tij në kapitalin themeltar.

Neni 3 Selia

3.1 Shoqeria e ka seline ne Tirane ne Adresen :Autostrada Durres Tirane, km 13, Vore, Picar. Njesia Administrative Vore,

3.2 Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Vetem.



Neni 4
Kohezgjatja

4.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 5
Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarise se Shoqerise "**F.R.Construzion shpk.**" perfshin:

5.1 Prodhim dhe dhenie me qera te skelave te ndertimit, import-eksporti i tyre sipas kerkesave te klienteve

5.2 Blerja, shitja, ndertimi, administrimi, i skelave per gjithesi, dhe perdorimi i tyre ne hapesira ndertimi mirembajtje, e restaurimi.

5.3 Shoqeria per permbushjen e objektit te saj mund te ndermar te tjera operacionet tregtare, ne sektorin e ndertimit meremetimit, ndertime industriale dhe jo industriale.

KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar

6.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10 000 000 (dhjetemilion) lekë, i ndare në 1 (nje) pjesë e barabarte, vlera nominale e të cilët eshte 10 000 000 lekë.

6.2 Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe do te shlyet tërësisht ne te holla nga ortaku i vetem i shoqerise **F.R.Construzion shpk.**, nepermjet transferes bankare, kuota me vlerë te per gjithshme 10 000 000 lekë, qe perbejne 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

6.3 Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontributë në shërbime.

6.4 Ortaku i vetem per gjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

7.1 Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit te nje Audituesi Ligjor per keto kontribute ne natyre sipas kërkesës së Ortakut te Vetem.

7.2 Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim te Ortakut te Vetem në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e Statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet Audituesve Ligjore, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpëra datës së mbledhjes së Asamnblese se Ortakut te Vetem të thirrur për të marrë vendim rrith këtij projekti.

7.3 Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 te ketij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në të kundërt shoqëria duhet të shndërrohet në një formë tjeter. Në rast mosbatimi të kërkesave të këtij paragarfi, çdo personi interesuar mund të kérkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mblidhet për të marrë vendim.

Neni 8
Transferimi i kapitalit

8.1 Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Ortakut te Vetem.

8.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve nepermjet akteve ligjore.

KREU II
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9
Organi Vendimmarres

9.1 Asamblea e Ortakut te Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

9.2 Asamblea e Ortakut te Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

9.3 Asamblea e Ortakut te Vetem brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratorët,

9.4 Asamblea e Ortakut te Vetem mund të përfaqësohet edhe nga një tjetër person, nepermjet prokures.

Neni 10
Ndryshimet e Statutit

10.1 Ndryshimet e statutit vendosen nga Asamblea e Ortakut te Vetem.

10.2 Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 11
Administrimi

11.1 Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblea e Ortakut te Vetem te shoqerise.

11.2 Ortaku i vetem vendos per sistemin e administrimit, dhe ne rastin e nje organi administrativ me shume administratore, percakton numrin e tyre dhe kompetencat.

11.3 Administratori/ret, mund te jene ose jo ortake.

11.4 Administratori/ret mund te shkarkohet ne cdo kohe.

11.5 Shoqeria do te funksionoj me nivel dy Administratoresh

11.6 Administrator te shoqerise jane:

11.6.a Fatos Roumelioti, shtetas Shqiptar, i biri i Vladimirit, lindur ne Seman, Fier, me 08 Shkurt 1985, banues ne Tirane, i identifikuar sipas ligjit nepermjet dokumentit te identifikimit me nr personal I50208020E.

11.6.b Renato Semini, shtetas Shqiptar, i biri i Gjergjit, lindur ne Fier, me 22 Mars 1965, banues ne Tirane ne adresen: Rruga Spiro Ballkamemi Nr 64, i identifikuar sipas ligjit nepermjet dokumentit te identifikimit me nr personal G50322118A.

11.7 Administratoret e shoqerise do te ushtrojne komptencat e tyre ne kete detyre per një periudhe 5 (pese) vjecare.

Neni 12
Kompetencat

- 12.1 Shoqëria administrohet nga dy Administrator. Administratoret kane të drejte të kryejne të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.
- 12.2 Administratoret përfaqësojnë Shoqërinë se bashku ose vec e vec përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve.
- 12.3 Administratoret kane të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rr Ethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Ortakut te Vetem te Shoqerise.
- 12.4 Administratoret angazhojne shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.
- 12.5 Administratoret kane gjithashtu të drejte të nënshkruajne kontrata të ndryshme në emër e për llogari te Shoqërisë, përfshi këtu kontratat e qirasë, shitjes, blerjes a hipotekimit të pasurive të paluajtshme, operacione financiare, të nënshkruajne aktet e themelimit të shoqërive të tjera ku Shoqëria është ortak, të nënshkruajne e hartojne çdo dokument e të kryejne në emër të Shoqërisë çdo veprim përballë të gjitha Bankave shqiptare apo te huaja në lidhje me çeljen apo mbylljen e llogarive rrjedhëse te Shoqërisë, nënshkrimin e kontratave te ndryshme bankare për financimin e Shoqërisë si dhe te kryejnee veprime tërheqje e derdhje shumash nga këto llogari pa limit.
- 12.6 Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rr Ethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.
- 12.7 Klauzolat e ketij Akt Themelimi që kufizojnë kompetencat e administratoreve, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.
- 12.8 Administratoret ose Ortaku që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 13
Pergjegjesite

- 13.1 Administratoret janë përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 13.2 Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asamblea e Ortakut te Vetem që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratoriteve se bashku ose vec e vec perkatesisht atij që ka bere marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale pasojat përkatëse.
- 13.3 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortaku ka të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratoreve ose administratorit që ka bere marrevshjen.
- 13.4 Ortaku ka të drejtë të ndjeke në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.
- 13.5 Ortaku që nuk eshte administrator, ka të drejtë në çdo kohë të informohet personalisht për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentet e shoqërisë.



Neni 14
Viti Financiar

- 14.1 Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.
14.2 Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 15
Pasqyrat Financiare te Shoqerise dhe Dividentet

- 15.1 Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese se Ortakut te Vetem, miraton Pasqyrat Financiare te paraqitura nga Administratoret.
15.2 Mbledhja e Asamblese se Ortakut te Vetem vendos rreth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e mbartura te viteve financiare, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 16
Audituesi Ligjor

- 16.1 Audituesi Ligjor ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithevetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e Ortakut të Vetem.
16.2 Ne perfundim të kontrollit Audituesi Ligjor pergatit raportin me shkrim opinionin per miratimin e Pasqyrave Financiare vjetore si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe Administrimit dhe Drejtimit te Shoqerise per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Neni 17
Miratimi i Pasqyrave Financiare vjetore

- 17.1 Pasqyrat Financiare Vjetore, miratohen mbi bazen e vendimit me shkrim nga Asamblea e Ortakut te Vetem, i cili jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të metejshem të shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecante per Rezervat Ligjore ne zbatim te legjislacionit ne fuqi.

Neni 18
Dividentet

- 18.1 Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondevë ligjore (Rezervave Ligjore ose Rezervave te tjera) të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretave, i mbesin dhe i kalojne ne pronesi, Ortakut te Vetem të Shoqerise.
18.2 Te ardhurat neto mund te shperndahen sipas Vendimit te Asamblese se Ortakut te Vetem ne formen e Dividentit pas pageses se Tatimit mbi Dividentin sipas normave ne fuqi.
18.3 Te ardhurat neto mund te mbahen per investime sipas Vendimit te Asamblese se Ortakut te Vetem sipas legjislacionit ne fuqi.



Neni 19
Shperndarje, Likujdimi ose Prishja e Shoqerise

- 19.1 Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkaku, edhe para plotesimit të afatit per të cilën eshte krijuar sic mund të jene :
- 19.2.a Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.
- 19.2.b Ne një nga menyrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"
- 19.2.c Kur ploteshohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.
- 19.3 Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1(një) apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoqeri ne likuidim e siper"

Neni 20
Bashkimi dhe ndarja

- 20.1 Shoqëria, me anë të bashkimit, mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ajo themelon.
- 20.2 Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërise të tjera ekzistuese ose disa shoqërise të reja.
- 20.3 Ortaku i Vetem i Shoqërise, që bën kalimin e trashëgimisë së saj në kuadrin e operacioneve të përmendura me lart përfiton pjesë të kapitalit themeltar nga shoqëria ose shoqëritë përfituese dhe sipas rastit një kompensim me para, vlera e të cilit nuk mund të kalojë 10% të vlerës nominale të pjesëve të kapitalit themeltar të dhëna.
- 20.4 Operacionet e përmendura me lart mund të realizohen ndërmjet shoqërise të formave të ndryshme.
- 20.5 Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim të shoqërise që zhduket, dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj t' e shoqëritë përfituese, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit.
- 20.6 Bashkimi ose ndarja sjell njëkohësisht për ortakët e shoqërise që zhduken marrjen e cilësisë së ortakëve t' e shoqërise përfituese sipas kushteve t' përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.

Neni 21
Likudatoret

- 21.1 Ne rastet kur Asamblea e Ortakut te Vetem vendos per kalimin ne Likujdim te shoqerise ne kushtet e likuidimit te zakonshem, ajo njekohësisht emeron një Likujdator per te ndjekur procesin e likuidimit te shoqerise.
- 21.2 Afati i emerimit të Likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne Aneksin e Regjistrat Tregtar.
- 21.3 Likuidatori eshte i detyruar qe t' jete i vemendshem dhe korekt, si per realizimin e të drejtave per subjektet ndaj t' cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debive qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve t' vecante apo personave fizik apo juridik vendas apo t' huaj.

Neni 22
Baza Ligjore

- 22.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 22.2 Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 23
Mosmarreveshjet

23.1 Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij Statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 24
Dispozita perfundimtare

24.1 Ky statut u redaktua ne 4 ekzemlare me permbajtje dhe vlera te njejtave juridike, ne gjuhen shqipe,dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i Vetem themelues i shoqerise tregtare **F.R.Construzion shpk.**, nenshkruehet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale, autenticiteti i te cilit vertetohet nga dokumenti i identifikimit ketu bashkengjitur.

ORTAKU I VETEM

FATOS ROUMECIOTI
